



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:272584

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 03772557

A.nr. 2926/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, në konfliktin administrativ të paditëses, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson me adresë në, kundër të paditurës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me seli në Prishtinë, me bazë juridike “anulim i vendimit”, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të palës paditëse e në mungesë të palës së paditur, me datë 05.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses, me të cilën ka kërkuar që të anulohen vendimi i datës 28.10.2022 dhe vendimi i datës 10.11.2022 me numër 122/2022 i të paditurës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me seli në Prishtinë, si e pa bazuar.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Seanca e shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, në prani të palës paditëse, dhe në mungesë të palës së paditur, e ftuar në mënyrë të rregullt (Provë: fletë-kthesa e datës 14.02.2024).

Paditësja me padinë e datës 20.12.2022 të parashtruar në këtë gjykatë dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, ka kërkuar nga gjykata që ta aprovojë në tërësi padinë e paditëses si të bazuar, ashtu që ti njihet e drejta e mbështetjes në pagesa direkte në bujqësi, në kuadër të programit për pagesat direkte për vitin 2022 dhe të anulohen tërësisht vendimet me numër Ref.AZHB.07/4/2-0321175/2022 i datës 28.10.2022 dhe Vendimi i të paditurës me numër 122/2022n i datës 10.11.2022, ashtu që të obligohet e paditura që paditëses ti bëjë kompensimin e dëmit dhe rimbursimin e shumës së përfituar në emër të mbështetjes në pagesa direkte në bujqësi për vitin 2022, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit. Si

dhe i ka kërkuar shpenzimet procedurale. E njëjta gjithashtu e ka njoftuar gjykatën se në rastin konkret për këto subvencione ka aplikuar si person fizik dhe jo si person juridik.

E paditura me përgjigjen në padi të datës 05.02.2024, i ka propozuar gjykatës që ta refuzojë kërkesëpadinë e paditëses në tërësi si të pa bazuar dhe ta lë në fuqi vendimin numër 122/2022 të datës 10.11.2022 të të paditurës, sepse është konstatuar dallim në mes të aplikimit dhe gjendjes në terren, prandaj paditësja është përjashtuar nga Programi i Pagesave Direkte për 3 vite sipas Udhëzimit Administrativ 02/2022.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt. 05.03.2024, ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendimi i datës 10.11.22, vendimi i datës 28.10.22, kopja e letërnjoftimit për, pagesa direkte e dt.29.07.22 dhe e dt.28.10.22, raporti i kontrollit për pagesa direkte e dt.26.10.22 numri i raportit kontrollues 23-17-23-133.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar.

Me vendimin e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë të datës 28.10.2022 paditësja është përjashtuar nga programet përkrahëse të përcaktuar në nenin 4,5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2022 për Pagesa Direkte në Bujqësi për vitin 2022 të datës 12.04.2022 me arsyetimin se pas kontrollës në terren është konstatuar se ka dallime mbi 50 % midis deklaramentit gjatë kohës së aplikimit dhe verifikimit në vend ngjarje.

Me vendimin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me numër 122/2022 , të datës 10.11.2022, të goditur me padi, është refuzuar ankesa e fermeres, tani paditëses, si e pa bazuar, ashtu që ka mbetur në fuqi vendimi i AZHB-së i datës 28.10.2022 me numër Ref.AZHB.07/4/2-032175/2022.

Paditësja e pakënaqur me vendimin e datës 10.11.2022 të të paditurës, ushtron padi në këtë gjykatë me datë 20.12.2022, duke kontestuar ligjshmërinë e tij.

Për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, gjykata iu referua Nenit 48 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 i Udhëzimit Administrativ – (MBPZHR) – Nr.02/2022 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2022 të datës 12.04.2022 në të cilin përcaktohet se: *6. Aplikuesi përjashtohet nga programet përkrahëse për tri (3) vite 2022, 2023 dhe 2024 në bazë të vendimit të Agjencisë për shkeljet si në vijim: 6.1. i ka paraqitur AZHB-së të dhëna të rrejshme sipas paragrafit 5 të këtij Neni;*” ndërsa paragrafi 5 i këtij neni përcakton se: *“Nëse dallimi midis numrit të deklaruar dhe të verifikuar nga paragrafi 1 i këtij*

neni është mbi 50%, atëherë fermeri nuk ka të drejtë për asnjë lloj përkrahje nga MBPZHR dhe aplikacioni i tij refuzohet dhe sanksionohet sipas paragrafit 6 të këtij neni''.

Gjykata nga shkresat e lëndës ka konstatuar se paditësja në formularin për aplikim për të qenë përfituese e përkrahjes në pagesa direkte në bujqësi sipas programit për pagesa direkte ka deklaruar 7.30 hektarë me kulturë Misër, 3.01 hektarë me kulturë Arra dhe 14 krerë Lopë qumështore, ndërsa me rastin e kontrollit në terren nga Inspektorët e AZHB-së është konstatuar se fermeres, tani paditëses, i janë gjetur 6.59 hektarë Misër, 3.01 hektarë Pemë Arra dhe 07 Lopë qumështore, andaj në bazë të këtij dallimi midis numrit të deklaruar dhe atij të verifikuar, paditësja është përjashtuar nga Programi i Pagesave Direkte për 3 vite sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2022.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e paditëses të dhëna në padi, por të njëjtat pretendime i refuzoi si të pa bazuara, nga arsyeja se paditësja të njëjtat nuk i ka provuar me fakte dhe prova të cilat kishin për të ndikuar që kjo gjykatë të mund të vërtetojë një tjetër gjendje faktike nga ajo që ka vërtetuar organi i paditur.

Prandaj, nga të lartë cekurat, gjykata në këtë çështje administrative vendimin e të paditurës e vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm, nuk ka të meta për shkak të cilave mund të anulohet, drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga e paditura, drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative, drejtë ka zbatuar ligjin material, kur ka hedhur poshtë si të pa lejuar ankesën e paditësit. Mbi këto arsye, gjykata kërkesëpadinë e paditëses nuk e aprovoi, sepse vlerësoi se nuk është zbatuar ligji në dëm të të njëjtës.

Lidhur me kërkesën e paditëses për kompensimin e shpenzimeve procedurale, gjykata vendosi konform nenit 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.2926/2022 data: 05.03.2024

G j y q t a r e

Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.